



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.11.2018 ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – Kryetare e komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi në parim dhe paraqitja nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, zoti Ditmir Bushati i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”

2. Çështje të tjera

Marrin pjesë: Mimi Kodheli, Andrea Marto, Adnor Shameti, Egllantina Gjermani, Xhemal Qefalia, Vasilika Hysi, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Bashkim Fino dhe Klotilda Bushka.

Mungojnë: Tritan Shehu, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Nard Ndoka, Klevis Balliu, Rudina Hajdari, Edmond Panariti dhe Elona Hoxha.

Të ftuar:

Ditmir Bushati – Ministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Gazmend Barbullushi – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Jashtme

Gentian Opre – Drejtor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Ina Dhaskali – Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Ilda Dega – Drejtoreshë e financave në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 6 nëntor 2018.

Në rend të ditës kemi shqyrtimin në parim dhe paraqitjen nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Të ftuar kemi zotin Bushati, ministër për Europën dhe Punët e Jashtme. Mirë se erdhe zoti Bushati! Gjithashtu, kemi zotin Barbullushi, sekretar i përgjithshëm, zonjën Dega, drejtoreshë e financës dhe zotërinjtë Opre dhe Dhaskali. Mirë se erdhët!

Zoti Bushati, fjala për ju.

Faleminderit!

Ditmir Bushati – Faleminderit, zonja kryetare dhe kolegë deputetë!

Faleminderit zonja nënkryetare e Kuvendit!

Sot sjellim këtu për diskutimin buxhetin e vitit 2019 për Ministrinë e Europës dhe Punët e Jashtme. Meqenëse një pjesë e mirë e kolegëve e kanë bërë diskutimin për projektbuxhetin në Komisionin e Ekonomisë dhe Financës dhe në komisione të tjera, do të përpiqem të jem konciz.

Së pari, flasim për një rritje të buxhetit me rreth 3% në raport me atë të vitit 2018 apo në përllogaritjen tonë buxheti që merr Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme zë 0.76% të produktit të brendshëm bruto.

Ky buxhet synon realizimin e prioritetëve që ne kemi për vitin 2019, si: integrimin europian të vendit, pra vijimin e procesit “*screening*”, zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit dhe të gjithë punës bashkërenduese për procesin e fillimit të bisedimeve për anëtarësim, gjithashtu, edhe koordinimin e asistencës që jep Bashkimi Europian. Pjesë e këtij prioriteti janë edhe aktivitetet kryesore politike që bëjmë gjatë gjithë vitit.

Prioritet i dytë është diplomacia ekonomike dhe puna që ne përpiqemi të bëjmë me diasporën apo me shqiptarët që jetojnë jashtë atdheut. Në këtë kontekst, përmes këtij buxheti ne do të vazhdojmë punën që kemi nisur në vitin 2018 me koordinimin e komisioneve të përbashkëta të karakterit ekonomik me shumë vende, me krijimin e bazës së të dhënave ndërinstitucionale për investorët e huaj, që do të vazhdojmë të bëjmë dhe me shqiptarët e suksesshëm në diasporë.

Prioriteti i tretë ka lidhje me çështjet e sigurisë, me marrëdhëniet me fqinjët dhe me shqiptarët në rajon.

Fakti që buxheti ka një rritje më të ndjeshme këtë vit nga vitet e tjera, ka të bëjë me objektivin tonë për të marrë drejtimin e OSBE-s në vitin 2020. Në rast se një gjë e tillë do të rezultojë e suksesshme, atëherë për Shqipërinë që në vitin 2019 do të lindin disa detyrime për shkak të hyrjes së vendit tonë në trojkën e OSBE-së. Kjo është arsyeja që në buxhetin e shtetit është parashikuar një fond specifik për aktivitetet që do të ndërmarrë Shqipëria gjatë vitit 2019.

Në vitin 2020, natyrisht me marrjen e presidencës së OSBE-së, do të duhet që ky fond të jetë akoma më i madh për të realizuar të gjitha detyrimet që ka një vend që mban drejtimin e OSBE-së. Në rast se një gjë e tillë do të finalizohet në ministerialin e Milanos këtë dhjetor, atëherë Shqipëria për herë të parë do të marrë kryesinë e kësaj organizate të rëndësishme. Deri tani ne kemi qenë konsumatorë jo thjesht të prezencës sonë në OSBE, duke ditur edhe rolin specifik që organizata ka luajtur në Shqipëri dhe në rajon, duke qenë se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një zyrë të OSBE-së pak a shumë me mision të njëjtë me atë që kanë në Shqipëri dhe për herë të parë gjithashtu ne do të kthehemi në kontribuues në këtë organizatë, aq më tepër që sot për sot është ndër të paktat forume ku vende të ndryshme, të cilat kanë lexime krejt të ndryshme për sa i përket të drejtës ndërkombëtare dhe rendit ndërkombëtar, takohen dhe e konsiderojnë OSBE-në si një forum dialogu.

Ne kemi bërë një skaner paraprak të kryesimit që i kanë bërë vende të ndryshme OSBE-së, për të kuptuar jo thjesht dinamikën që do të duhet të ndjekim gjatë 2019-ës dhe 2020-ës, por edhe dimensionin financiar të kësaj sipërmarrjeje. Ne besojmë që me këtë fond të alokuar për 2019-ën, kemi mundësi që të përgatisim veten tonë në trojkë dhe kryesisht për aspektet mesdhetare që lidhen me organizatën.

Po kështu, brenda këtij prioriteti reflektohet edhe mbështetja financiare që ne bëjmë për sa i përket vijimit të fushatës për një vend jo permanent në Këshillin e Sigurimit 2022-2023, votim i cili do të kryhet në qershorin e 2021-it, por që është një proces pune në vijimësi, i nisur disa vite më parë dhe kërkon një komunikim të zhdërvjelltë për një pjesë të vendeve, të cilët nuk e njohin Shqipërinë në aktivitetin e saj të përditshëm dhe në çështjet që kanë të bëjnë me vlerën e shtuar që mund të sjellë Shqipëria në Këshillin e Sigurimit.

Prioritet i katërt janë çështjet që kanë të bëjnë me modernizimin e mëtejshëm të sistemit dhe përmirësimin e shërbimeve konsullore. Ne kemi disa vite që jemi futur në procesin e digjitalizimit të shërbimeve konsullore, duke reduktuar në maksimum kontaktet fizike mes shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë atdheut, dhe sporteleve tona konsullore.

Këtë vit, ne vijmë edhe me dy projekte të reja mbështetëse, të cilat nuk figurojnë në buxhetin e Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme, por përfitues jemi ne. Janë dy projekte të cilat do të zbatohen dhe prokurohen nga AKSH-i. Njëri ka të bëjë me komunikimin në rrjete-

qendër dhe përfaqësi, e cila mundëson komunikimin e kriptuar elektronik nga qendra në përfaqësi, duke qenë se Ministra për Europën dhe Punët e Jashtme është një prej atyre institucioneve që trajton informacion të klasifikuar dhe projekti tjetër ka të bëjë me sistemin e –viza, që do të mundësojë trajtimin e vizave në mënyrë digjitale. Kjo është faza e dytë e një procesi që kemi nisur për digjitalizimin e të gjitha shërbimeve që ofrojmë, si për shtetasit tanë, ashtu edhe për shtetasit e huaj, të cilët në këtë rast synojnë të hyjnë në territorin shqiptar përmes vizave.

Çështjet e tjera që preken direkt nga buxheti i paraqitur janë ato çështje klasike që ne i kemi diskutuar çdo vit. Si për shembull, janë kuotat apo kuotistacionet ndërkombëtare, pra detyrimet që ka Shqipëria në instanca dhe në organizma ndërkombëtarë, janë projektet me financime të huaja ku ju keni pasur edhe debat të gjatë për sa u përket bashkëfinancimeve dhe kontributit që japin vendet kryesisht në projektet ndërkufitare të mbështetura nga Bashkimi European, regjistrimi i shtetasve shqiptarë, duke qenë se në vitin 2018 ka kaluar dhe e gjithë baza e akteve normative për këtë proces dhe rikonstrukcioni i pjesëve të ndryshme logjistike të institucionit.

E fundit, para se të kalojmë te seanca e diskutimeve apo pyetje – përgjigjeve, këtë vit për herë të parë që nga viti 2006, qeveria ka vendosur për të bërë një rritje cilësore në lidhje me pagat e diplomatëve dhe të gjithë njerëzve që punojnë në shërbimin e jashtëm, pra qofshin këta diplomatë apo staf teknik, me të paktën 20%. Kjo rritje do të reflektohet nga 1 prilli i vitit të ardhëm. Ky është një kontribut i mëtijshëm për ta stabilizuar shërbimin e jashtëm dhe për ta sjellë në parametrat e një pune normale, që e kanë edhe vendet e tjera të rajonit.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Bushati!

Po fjala për ju kolegu Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Në radhë të parë dua të falënderoj diplomacinë shqiptare dhe ministrin për impenjimin e shtuar në raport me OSBE-në. Kjo me të vërtetë që tregon maturi dhe shpresoj që ky komision dhe anëtarët e Komisionit të Ekonomisë të vazhdojnë ta mbajnë impenjimin buxhetor për atë që vijon.

Projektbuxheti i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme është pjesë e hartimit të programit buxhetor afatmesëm. Krahasuar me buxhetin e vitit 2018, ky projektbuxhet vjen me një rritje me vlerë absolute 83.3 milionë lekë ose me 3% dhe në raport me GDP-në dhe PPB-në, është në nivelin 076%.

Në projektet me financim të huaj janë parashikuar 220 milionë lekë, të cilat përfaqësojnë fondet që jep Bashkimi European për programet dhe bashkëpunimet territoriale.

Për sa i takon organikës dhe numrit të punonjësve të kësaj ministrie, ky institucion do të jetë me 551 punonjës, nga të cilët 365 janë punonjës me misione diplomatike dhe poste konsullore jashtë vendit dhe 195 janë punonjës në ministri.

Për sa më sipër i rentuar nga prioritetet e politikës së jashtme, projektbuxheti i vitit 2019 mundëson kapacitetin e nevojshëm të mbështetjes financiare me qëllim mbylljen e reformave të nisura gjatë viteve të mëparshme dhe realizimin e objektivave të reja si:

Hapjen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian, duke mbështetur strukturat e administratës publike që do të angazhohen në procesin e njohur “*screening*”.

Zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me prioritet partneritetin strategjik.

Vazhdimin e angazhimeve për njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrje dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale e ndërkombëtare.

Funksionalizimin dhe mbështetjen e punës së dy nismave rajonale me seli në Tiranë. Zyra rajonale për bashkëpunimin rinor dhe fondi i Ballkanit perëndimor, si dhe në tërësi i pjesëmarrjes aktive në bashkëpunimet shumëpalëshe rajonale.

Kryesimin e disa nismave rajonale dhe organizatave ndërkombëtare.

Pjesëmarrjen aktive dhe realizimin e kontributit të Republikës së Shqipërisë në kuadër të NATO-s.

Zbatimin e detyrimeve të anëtarësimit në organizatat dhe forumet shumëpalëshe.

Plotësimin e bazës ligjore në bashkëpunim me vendet e tjera.

Forcimin dhe rritjen e rolit të diplomacisë publike ekonomike dhe diasporës në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë.

Promovimi i potencialit për investime në tregti dhe bashkëpunim ekonomik tregtar e kulturor me partnerët tanë ndërkombëtarë dy dhe shumë palësh. Dje patëm edhe një ekspozë nga ministri Majko për të njëjtën raport me diasporën.

Realizimin e shërbimit konsullor të mbështetur në profesionalizëm dhe transparencë.

Të gjitha këto janë pjesë e programit që kemi paraqitur ne si maxhorancë dhe shpresoj në votën pro të të gjithë kolegëve deputetë.

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Bushati!

A ka pyetje?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit ministrit të Jashtëm dhe stafit që ka ardhur këtu, që nuk kërkon asgjë dhe është, me sa pashë unë, i gatshëm të thotë se ky projektbuxhet është më se në rregull për pjesën

e vet. Neve na vjen mirë, sepse nuk na vë para ndonjë përgjegjësie për të bërë ndonjë rialokim të mundshëm. Aq më tepër me Bushatin -deputet, që i lexoi shumë mirë prioritetet.

Pyetja që kam unë në lidhje me relacionin e projektbuxhetit, është se janë pikërisht të gjitha prioritetet e vitit 2019 – 2021, të cilat edhe kolegu im Bushati, Bushati – deputet i lexoi shumë mirë dhe i tha saktë e drejtë. Unë dua të di si janë përkthyer këto në shifra. Sepse, më lejoni t’ju them, meqenëse jam edhe financier, ka një mospërputhje të shifrave në raport me 2019-ën, që ne do të miratojmë dhe 2020-ën. Cilat janë ato?

Ju, zoti Ministër, thatë se në lidhje me marrjen e presidencës së OSBE-së nga ana jonë më 2020, të jeni të bindur se do të ketë më shumë fonde nga qeveria për ministrinë tonë e të tjera e të tjera. Mua më vjen mirë për këtë, por po të shikosh shifrat, për vitin 2019 ju kanë planifikuar 2 milionë e 707, 5 milionë lekë, ndërkohë që për 2020-ën ju kanë planifikuar 2, 642, 3. Flas gjithmonë për shifrat e financimit të brendshëm. Nëse do ta them edhe në total se sa e ke. Për vitin 2019 e ke 3 milionë e 0,80, ndërkohë për vitin 2020, në total e ke 2 milionë e 820. Kjo do të thotë se ka një rënie sa u takon fondeve që janë planifikuar, ashtu sikundër ka, duhet ta shpjegoj këtë gjë, që të jem korrekt me veten e me ju, një rritje të konsiderueshme për vitin 2021, një rritje prej 2-3 milionë më tepër se sa vitit 2020. Kjo do të thotë se në lidhje me këto shifra, të cilat janë nën nivelin e lartë të 2019-ës, ka një rënie në 2020-ën, ka një rritje të konsiderueshme në 2021-shin. A ju pengojnë ju për aktivitetin tuaj të përditshëm si Ministri e Evropës dhe Punëve të Jashtme, aq më tepër kur do të merrni edhe drejtimin e OSBE-së në vitin 2020, gjë e cila kërkon akoma më shumë fonde? Apo thjesht është bërë një përlllogaritje e gabuar nga ju dhe Ministria e Financave, për të dhënë një detaj më të saktë të këtyre shifrave?

Faleminderit! Pres përgjigje, që të komentoj përsëri.

Zonja Kushi, kishit pyetje? Mendoj t’i mblidhni të gjitha pyetjet e pastaj të përgjigjeni, zoti Ministër.

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit kryetare!

Faleminderit shumë, zoti Ministër, për prezantimin e aktiviteteve, objektivave dhe buxhetit për ministrinë tuaj për vitin 2019.

Unë kam një pyetje që lidhet pikërisht me buxhetin e vitit 2019 për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Në qershorin e vitit 2019 Shqipëria pret hapjen e negociatave me Bashkimin Europian. Unë desha të dija nëse ky vendim që do të merret ndikon në detyra shtesë, funksione shtesë, të cilat pastaj përkthehen në buxhete shtesë për ministrinë tuaj dhe a janë reflektuar këto? Pra, a

janë marrë të mirëqena, që të gjitha këto buxhete të jenë të reflektuara në buxhetin specifik për ministrinë tuaj?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Nëse nuk ka pyetje të tjera, kam unë një pyetje, në vijim të pyetjeve të kolegut Fino. Për sa kam hulumtuar në lidhje me buxhetin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, më rezulton se marrja e presidencës së OSBE-së nga ana e Shqipërisë, në vitin 2020, duhej të përkthehej në një fond shtesë. E kuptoj se ka pasur një shpejtësi në vendimmarrjen e shteteve anëtare apo qoftë edhe në propozimin nga ana jonë për t'u ofruar si drejtues të radhës, por besoj se Ministria e Financave dhe qeveria në përgjithësi ka pasur mjaftueshëm kohë që të mund të rialokonte fonde shtesë për ministrinë e Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, me qëllim përballjen e drejtë, pse jo me këtë nder që i bëhet Shqipërisë, pra me marrjen e presidencës.

Kësisoj, do të doja që, në mënyrë më specifike, qoftë nga ana juaj, Ministër, por edhe nga ana e koleges së vjetër Dega, të mund të na shpjegonit se ku konsiston kjo rritje, apo nëse kjo rritje e mbështet realisht këtë vendimmarrje. E mirëkuptoj faktin se projektbuxheti për vitin 2019 është pjesë e projektbuxhetit trevjeçar afatmesëm, por ne po diskutojmë për 2019-ën, në një kohë që nuk do të na mjaftonte një shtesë e vitit 2021, nëse presidencën do ta marrim vitin tjetër.

Gjithashtu, i bashkëngjitem shqetësimit të koleges Kushi, lidhur me hapjen e negociatave, padyshim edhe asaj çfarë ju, me të drejtë përmendët: marrjen e karriges së një ndër anëtarëve të përkohshëm të Komisionit të Sigurisë, pranë OKB-së pak vite më vonë.

Zoti Ministër.

Ditmir Bushati – Faleminderit, zonja kryetare!

Të tria këto procese, të cilat u përmendën këtu: fillimi i bisedimeve për anëtarësim, marrja e kryesisë së OSBE-së, që ka një përshkallëzim, fillimisht në trojkën, në 2019-ën, në rast se vendimi do të merret, meqenëse ende nuk ka një vendim përfundimtar në lidhje me këtë çështje. Më pas është beteja që bëhet për të siguruar një vend në Këshillin e Sigurimit, dhe ulja në tryezën më të rëndësishme sot për sot, sa u takon punëve globale. Për ne, këto janë dy shina të qarta. Njëra shinë ka të bëjë me fuqizimin e kapaciteteve tona, sa i takon planit njerëzor dhe diplomatik, sepse niveli i ndërveprimit me shtete të tjera, me partnerë, me institucione, do të jetë i tillë, që nuk është provuar deri më sot. Sikundër, duke filluar që nga OSBE-ja, ka dy-tre institucione kyçe. Ministria e Mbrojtjes, për shembull, apo Ministria e Brendshme, që për shkak të profilit të organizatës do të duhet të kenë një prezencë më të shtuar të personelit të tyre,

brenda radhëve të misionit shqiptar në OSBE. Kjo nënkupton se një gjë e tillë të pasqyrohet edhe në koordinimin e brendshëm ndërinstitucional.

Pra, në kuptimin metaforik të fjalës, ne jemi vitrina apo institucioni i dukshëm, për shkak se koordinojmë këtë proces, por ka edhe disa institucione të tjera, të cilat gjithashtu do të kyçen në këtë lloj dinamike të re.

Për t'i marrë pyetjet me radhë, sa i përket OSBE-së, këtu ne po flasim për vitin 2019; është e vërtetë se, në rast se u referohemi shifrave të 2020-ës, në PBA nuk është reflektuar në mënyrë të përshkallëzuar. Le të themi se kandidatura jonë për në OSBE nuk ka qenë e parashikuar në vitin 2015 apo në vitin 2016. Pra, ka një diskutim, që është bërë relativisht në mënyrë diskrete këta katër-pesë muajt e fundit. Nuk është ende përfundimtare, insistoj ta them këtë. Me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave ka një rakordim të plotë për sa i përket edhe angazhimit financiar të kësaj sipërmarrjeje, gjithashtu në mënyrë të përshkallëzuar. Shifrat që ne disponojmë dhe skanerin, ne e kemi bërë nga kryesi të ndryshme. Kemi një kryesi, siç ishte ajo kazake, serbe, irlandeze, sllovake, që do të jetë para nesh gjithashtu për herë të parë, një vend i cili, pavarësisht faktit se është vend anëtar i Bashkimit Europian, është relativisht i ngjashëm me ne sa i takon madhësisë dhe, le të themi, sa i takon lojës në teatrin ndërkombëtar.

Do të ishin disa nga modelet, le të themi udhëzuese, udhërrëfyese edhe për faktin se çfarë do të parashikohet në 2020-ën. Sepse ne nuk mund të marrim, s'është blasfemi ta them këtu, presidencën gjermane apo kryesinë gjermane të OSBE-së, duke qenë se është vendi më i fuqishëm në Europë, është një pol stabiliteti dhe, përmes politikës së jashtme projekton shumë lloj iniciativash. Në rast se u referohemi shifrave të kryesisë gjermane, për një vend si Shqipëria shifrat mund të duken të ekzagjeruara.

Dua t'ju siguroj se në lidhje me këtë çështje ka një diskutim me Ministrinë e Financave, ndërsa në mars, kur fillon edhe procesi përgatitor për rishikimin e PBA-së, një gjë e tillë do të reflektohet.

Sfidë për ne mbetet pjesa tjetër, sepse kërkohet të reformohet mënyra e të menduarit dhe të vepruarit, jo thjesht sa i takon shërbimit të jashtëm, por edhe instancave që do të preken nga pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë iniciativë.

Pyetja e dytë, e cila u shtrua nga kolegja Kushi, është me shumë vend. Për sa i përket objektivit që kemi në procesin e integritetit europian, jemi duke u përpjekur ta zhvillojmë veprimtarinë tonë në dy pista.

Njëra është pista politike. Janë disa detyra, të cilat ne i quajmë detyra shtëpie për të gjithë aktorët politikë, përfshi edhe deputetët e opozitës, të cilët nuk janë sot këtu dhe kanë refuzuar dosjet rozë që janë shpërndarë në tryezë. Në këtë kontekst, përfundimi i punës për

reformën zgjedhore, një kalendar i qartë për sa i përket zbatimit të reformës në drejtësi e kështu me radhë, janë detyrime dhe përgjegjësi të përbashkëta. Ka edhe përgjegjësi të karakterit ekzekutiv, siç është puna që ne po bëjmë në procesin *screening*, që ka filluar me dy kapitujt e parë, kapitujt 23 e 24, të cilët konsiderohen edhe tharmi i të gjithë filozofisë së procesit të bisedimeve për anëtarësim dhe të strukturave që po ndërtojmë për këtë proces.

Edhe këtu kemi një qasje graduale. Fillimisht do të kemi fuqizimin e strukturës koordinuese në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme. Natyrisht, kjo do të shoqërohet edhe me fuqizimin e strukturave dhe nukleve koordinuese nëpër të gjitha institucionet e ekzekutivit, por edhe jashtë ekzekutivit, sepse, sidomos për dy kapitujt që kanë të bëjnë me sundimin e së drejtës: kapitujt 23 e 24, një pjesë e mirë e përgjegjësive duhet të ushtrohen nga institucione që janë jashtë juridiksionit të ekzekutivit.

Po kështu, pjesë e kësaj strategjie do të jetë fuqizimi i prezencës në Bruksel. Në qoftë se sot për sot kemi vetëm diplomatë, shumë shpejt do të ketë ekspertë e nëpunës civilë, të cilët emërohen përmes një procesi të parashikuar nga ligji “Për shërbimin e jashtëm”, por që atashohen pranë misionit tonë atje, në përputhje me prioritetet që do të marrë procesi i bisedimeve për anëtarësim. Besojmë se në terma financiarë, kjo do të prekë më shumë vitin 2020 se sa vitin 2019.

Të dyja këto procese dhe mënyra se si do të veprojë Shqipëria, do të jenë një test për sa i përket maturisë që ka vendi ynë për të përballuar angazhime ndërkombëtare, të cilat deri dje mund të kenë qenë të pamenduara, për të shkuar gradualisht drejt votimit për në Këshillin e Sigurimit në 2021-shin, ku edhe aty do të përballemi me një eksperiencë të papërjetuar më parë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, Ministër!

Ka diskutime?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Shumë shkurt, do të doja të thosha se, duke parë dinamikën dhe progresin që kemi në gjithë procesin e integritetit, por edhe negociatave që do të zgjerohen më tej, unë mendoj se është koha që në këtë komision të vijnë edhe propozime, jo thjesht për shtesa, ndryshime, rialokim, por edhe për rritje të fondeve, që, duke komunikuar edhe me Ministrinë e Financave, të fillojnë të reflektohen patjetër edhe në PBA, sepse do të duhet të rriten disa koeficientë në lidhje me mënyrën se si do të trajtohet në të ardhmen. Ne me të vërtetë nuk e dinim kur është bërë PBA-ja, që të mund të vinte rasti. Ky është edhe diskutim politik, ndonëse ka një sens kronologjik, po prapë më shumë politik, kështu që nuk mund të ndjehej në atë

moment, por në të ardhmen do të jetë mirë që, nëse do të ketë rritje procesesh, shtim, avancim e të tjera, ne do të jemi gjithnjë e më shumë të impenjuar, si në këtë komision, edhe në Ministrinë e Financave, të fillojnë të paraqiten që në PBA, që të jenë te pikat prioritare, sepse integrimi është pikë prioritare në të gjithë shoqërinë shqiptare, por edhe në politikën tonë.

Këtë kisha. Mendojmë të kalojmë ne votim, nëse nuk ka ndonjë gjë tjetër.

Mimi Kodheli - Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj ministrin për prezantimin!

Doja të vlerësoja buxhetin, jo thjesht për shumën që sjell, për faktin që rritet për disa tregues, për faktin se buxhetit që u prezantua i shtohet edhe pjesa e investimeve të huaja, por edhe pjesa e projekteve të AKSH-it, që është për dixhitalizimin e shërbimeve e rrit më shumë pjesën e buxhetit të Ministrisë së Jashtme.

Doja të theksoja një nga risitë që ju e përmendët pak, që ka të bëjë me rritjen e pagës së punonjësve të shërbimit të jashtëm, për mua është një gjë shumë e mirë, ju komplimentoj, sepse mendoj se iu rrit më shumë statusin, figurën, profesionalizmin dhe vlerat, por edhe pjesën e krahasueshme me vendet e tjera në rajon, se gjithmonë kemi thënë që diplomatët nga Kosova trajtohen më mirë, vlerësohen më shumë sesa tanët dhe në këtë drejtim them se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po flasim për buxhetin e Ministrisë së Europës dhe të Punëve të Jashtme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur të diskutojmë buxhetin e parlamentit do të flasim edhe për këtë gjë.

E vlerësoj këtë gjë dhe ju uroj shumë suksese, sepse është vërtet një arritje dhe rrit më shumë profesionalizmin, cilësinë e punës dhe statusin e diplomatëve tanë!

Faleminderit!

Bashkim Fino - Ju kërkoj ndjesë, kur bëjmë diskutime dhe krahasime, ne mundohemi që të trajtojmë gjërat si në rastin konkret, siç thatë ju që vërtet diplomatët kosovarë trajtohen më mirë, ndërkohë ka ardhur kohë që diplomatët shqiptarë të trajtohen më mirë. Më vjen mirë që më 1 prill të vitit në 2019 do të ketë rritje të pagave 30%.

Unë bëra një pyetje pak teknike, por që ka të bëjë me programin afatmesëm të qeverisë dhe të ministrisë për vitet 2019-2020-2021 dhashë disa shifra të cilat janë këtu në material. Më vjen mirë që ministri e ka nën kontroll situatën qoftë atë diplomatike, qoftë atë financiare. Kjo është shumë e rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por duke menduar që integrimi është më i rëndësishëm edhe për atë që tha ministri se në vitin 2020 ne do të kemi fatin të drejtojmë si shtet OSBE-në, drejtimin e radhës, do të thotë se duhet të kontrollohen shifrat dhe duhet ta ketë më nën kontroll anën financiare, se për anën diplomatike na shkatërroi, por për anën financiare besoj se duhet të jetë edhe më i sigurt, sepse shifrat janë kokëforta dhe duhet të realizohen mbi bazën e asaj çfarë ne kërkojmë. Shumë mirë që ka rritje të pagës, shumë mirë që marrim drejtimin e OSBE-s, por kam përshtypjen se do të jetë bërë ndonjë gabim teknik, i cili duhet të korrigjohet. Ne e kemi kohën e nevojshme se bëhet fjalë për vitin 2020, ndërkohë që jemi duke diskutuar për projektbuxhetin e vitit 2019. Nuk më mbetet gjë tjetër vetëm ta miratoj me kënaqësi dhe nën kontrollin që ministri i Punëve të Jashtme dhe Europës e ka anën diplomatike dhe atë financiare.

Mimi Kodheli - Faleminderit, kolegu Fino!

Besoj se në mënyrë krejt shteruese kemi diskutuar një pjesë të rëndësishme të projektbuxhetit për vitin 2019. Shpeshherë në këtë tryezë janë diskutuar çështje të rëndësishme që i përkasin jo vetëm diplomacisë mirëfilli, por edhe çështje që kanë të bëjnë me financat, si dhe çështje teknike. Shumëkush nga ambasadorët që ju keni sjellë për dëgjese kanë kërkuar dhe shprehur dëshirën që të kenë më shumë staf dhe më shumë fonde për ta zhvilluar më mirë aktivitetin e tyre. Ne u kemi premtuar zotërinjve ambasadorë që kur të vijë buxheti, këtë gjë do t'ia kërkonim qeverisë në përgjithësi dhe ministrit.

Pra, zoti Ministër mendoj se edhe rishikimi në gjykimin tonë modest, i numrit të stafeve kur flitet për përfaqësinë tonë në Vjenë, në OSBE, kur flitet për disa përfaqësi në vendet fqinj, si një politikë që ne e kemi shumë për zemër dhe detyrim tonin që të kemi një zgjerim të marrëdhënieve dypalëshe, vetë bashkëmbledhjet e qeverive respektive kanë treguar se ky intensifikim do të ketë një zhvillim pozitiv në të ardhmen, janë gjëra që unë besoj dhe shpresoj fort se me rialokimet që mund të ndodhin dhe brenda për brenda projekteve dhe zërave të buxhetit të mund t'i mirëmenaxhoni.

Nuk më mbetet gjë tjetër, përveçse t'ju komplimentoj dhe ta kaloj edhe me lejen e medias këtu, që i tërheq vëmendjen se “duhet ta kenë vëmendjen në mësim”, kemi pas thënë ne dikur. Unë, Vasilika, Eglandina edhe Evisi e kemi zanat të vjetër mësimdhënien dhe tërhiqim ndonjë herë vëmendjen për ta pasur atë në mësim, që të flasin më pak gjatë kohës që janë këtu prezent.

Kolegë, e hedhim në votim. Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Shpresojmë që javën tjetër do të kemi sekretarin e Përgjithshëm, zotin Barbullushi, ndoshta kolegen e vjetër Dega dhe cilindo tjetër për diskutimin nën për nën.

Faleminderit, zoti Ministër!

Punë të mbarë!

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA